



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

PËR

DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10304, DATË 15.7.2010,
“PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.10304, datë 15.7.2010, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Titulli i seksionit të dytë të kreut IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Autorizimi i tregtimit dhe veprimtaritë studimore projektuese”

Neni 2

Neni 33 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 33

Veprimtaritë studimore-projektuese

1. Veprimtaritë studimore-projektuese në fushën minerare mund të kryhen vetëm nga persona fizikë ose juridikë, që kanë të punësuar persona të

certifikuar në veprimtarinë studimore-projektuese në fushën minerare. Subjektet detyrohen të regjistrojnë në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare.

2. Certifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.”.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Licencat aktuale për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese ruajnë vlerën e tyre.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI